



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MBROJTJES



22-28 SHTATOR JAVA E MBROJTJES

QENDËR RAJONALE E INDUSTRIË SË MBROJTJES

Programi Qeverisës 2025–2029 thekson mbrojtjen si një prioritet kryesor, me objektivin që Shqipëria të shndërrohet në një qendër rajonale të industrisë së mbrojtjes. Planit parashikon rritje të buxhetit, aktivizimin e industrisë ushtarake “Made in Albania”, zgjerimin e kapaciteteve detare, fuqizimin e mbrojtjes civile dhe përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të NATO-s.

★★★★★



MINISTRI VENUGU NË MINISTERIALIN E MBROJTJES NË BRATISLAVË

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu mori pjesë në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor, i cili këtë vit u zhvillua në Bratislavë të Sllovakisë. Konferenca e këtij viti kishte në fokus industrinë e mbrojtjes, modernizimin dhe armatimin, si prioritetet kryesore të presidencës sllovake. Ministri Vengu theksoi se Shqipëria është një prodhues stabiliteti dhe sigurie në rajon.

★★★★★

STËRVITJE ME ANIJEN GJERMANE

Efektivi i anijes 'Lissus' P-133 zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen gjermane 'RUEGEN' A-1453 në kuadër të misionit të NATO-s në Detin Egje, duke ushtruar manovra detare dhe komunikim me flamuj. Qëllimi ishte forcimi i bashkëpunimit dhe përmirësimi i aftësive për operacione të përbashkëta.

JM



KESHILLI BASHKIAK DELVINE

DELIVINË, NIS PROJEKTI I RIJETËZIMIT

Në Delvinë nis një kapitull i ri rijetëzimi dhe forcimi kapacitetesh pas vlerësimit të dëmeve nga zjarret po trajtohen nevojat për banesat, blegtorinë dhe bletërritësit, ndërsa do të vijojnë projektet për rijetëzimin e lagjeve historike dhe ripyllëzimin e kurorës së gjelbër. Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile do të mbështesin Bashkinë Delvinë me ngritjen e qendrave rajonale të emergjencave.

★★★★★

SHQIPËRIA NË KOMITETIN USHTARAK TË NATO-S

Në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, zhvilluar në Letoni, mori pjesë edhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjenerallejtënant Arben Kingji. Diskutimet u fokusuan në sfidat e sigurisë, modernizimin, si dhe rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor dhe angazhimin e Shqipërisë në kuadër të Aleancës.

★★★★★



BMEC NË TRAJNIM ME EFEKTIVËT NGA KOSOVA DHE TURQIA

12 efektivë të BMEC morën pjesë në trajnimin e avancuar të kërkim-shpëtimit urban me kolegët nga FSK dhe Turqia për të forcuar aftësitë reaguese në rast fatkeqësish natyrore dhe njerëzore. Trajnimi u zhvillua nga instruktorë vendas dhe ndërkombëtarë, duke shkëmbyer përvojë dhe teknika të avancuara.

JM

★★★★★



STUDENTËT E AFA DHUROJNË GJAK

64 studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura dhuruan sot gjak vullnetarisht në bashkëpunim me Qendrën e Transfuzionit të Gjakut. Nisma, e kthyer tashmë në traditë, u vlerësua nga Zv. Ministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, për solidaritetin dhe humanizmin e studentëve.

JM



FESTIVAL Festival



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



OSFA, KONCERT NË KORÇË

Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura performoi në Korçë në kuadër të Ditëve Europiane të Trashëgimisë Kulturore, duke sjellë muzikë dhe atmosferë festive për publikun.

JM

★★★★★

mod.gov.al